



Prishtinë, 04.10.2021  
Kodi i ZRRE-së: V\_1425\_2021

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke u bazuar në:

- Nenin 9 paragrafi 1 nënpar. 1.7, nenin 15, nenin 16, nenin 25 dhe nenin 26 paragrafi 1 nënpar. 1.2 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Nenin 16 paragrafi 1 nënpar.1.41 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085);
- Nenin 16 i licencës së Operatorit të Sistemit të Transmetimit, dhe
- Kërkesën e KOSTT të datës 23 mars 2021 për aprovimin e dokumentit Propozimi i të gjitha TSO-ve kontinentale evropiane për Rregullat e përbashkëta të barazimit përfundimtar për shkëmbimet e paqëllimshme të energjisë,

në seancën e mbajtur me 04 tetor 2021, nxori këtë:

## V E N D I M

- I **APROVOHET** – kërkesa e KOSTT SH.A. Propozimi i të gjitha TSO-ve kontinentale evropiane për Rregullat e përbashkëta të barazimit përfundimtar për shkëmbimet e paqëllimshme të energjisë në përputhje me Nenin 51 (1) të Rregullores së Komisionit (BE) 2017/2195 të 23 nëntorit 2017 që është rregullore udhëzuese mbi balancimin e energjisë elektrike.

## A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 23 mars 2021 ka pranuar kërkesën e KOSTT për aprovimin e dokumentit Propozimi i të gjitha TSO-ve kontinentale evropiane për Rregullat e përbashkëta të barazimit përfundimtar për shkëmbimet e paqëllimshme të energjisë në përputhje me Nenin 51 (1) të Rregullores së Komisionit (BE) 2017/2195 të 23 nëntorit 2017 që është rregullore udhëzuese mbi balancimin e energjisë elektrike.

Propozime vjen si rezultat i detyrimeve ligjore që dalin nga dokumenti Synchronous Area Framework Agreement (SAFA), pjesë zbatuese e të cilës është edhe KOSTT.

Zbatimi i rregullave të përbashkëta mundëson integrimin në tregjet balancuese të energjisë elektrike dhe lehtësohet krijimi i platformave të përbashkëta Evropiane për operimin e procesit të netimit të jobalanceve dhe mundësohet shkëmbimi i energjisë balancuese nga rezervat e restaurimit të frekuencës dhe rezervat zëvendësuese.



Bordi i ZRRE-së, pas vlerësimit të kërkesës së KOSTT SH.A., dokumentit - Propozimi i të gjitha TSO-ve kontinentale evropiane për Rregullat e përbashkëta të barazimit përfundimtar për shkëmbimet e paqëllimshme të energjisë në përputhje me Nenin 51 (1) të Rregullores së Komisionit (BE) 2017/2195 të 23 nëntorit 2017 që është rregullore udhëzuese mbi balancimin e energjisë elektrike, ka vlerësuar se dokumenti duhet të aprovohet, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

III. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi, palët e pakënaqura mund ti drejtohen Gjykatës Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

**Bordi i ZRRE-së:**

Ymer Fejzullahu, kryesues

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Lutfije Gashi, anëtare

Gani Buçaj, anëtar

Vendimi iu dërgohet palëve:

- Të licencuarit KOSTT Sh.A.
- Arkivit të ZRRE-së.